



BPrAL - PPOHE
Kolegji AAB

Programi Komunikim Masiv dhe Gazetari (MA)

PROJEKT TEMA E MASTERIT

Roli i Medies në Integrimet Kulturore Evropiane te Kosum

Kandidati
Valjeta Kosumi

Mentori
Rahman Paçarizi

Dt, 19.03.2014
Prishtinë



Kandidati: Valjeta Kosumi
Nr,indeksit: FKM026M/09
Kolegji: AAB
Drejtimi: Komunikim Masiv dhe Gazetari
Programi: Master
Mentori: Rrahman Paçarizi

Hyrje;

“E ardhmja e Kosovës është në Bashkimin Evropian dhe kjo është rruga e saj e vetme”. Ky konstatim është dhënë gjatë viteve të fundit si nga përfaqësues të politikës vendore në Kosovë, po ashtu edhe nga politikanë e diplomatë ndërkombëtarë, përfshirë edhe përfaqësues të institucioneve evropiane.

Por si është duke ecur Kosova drejt integritimit në institucionet evropiane? Kosova është e fundit në rajon sa i përket hapave dhe kritereve që duhet plotësuar për të qenë pjesë e BE-së. Kjo gjë, nga shumëkush, arsyetohet për shkak të kaluarës së saj, faktit që është shtet i ri dhe mos njohjes së saj nga 5 vende anëtare të BE-së.

Traktati për Bashkimin Evropian thekson se cdo vend evropian mund të aplikojë për anëtarësim po që se ai vend respekton vlerat demokratike të BE-së dhe është i përkushtuar që t'i mbështesë ato. Por një vend mund të anëtarësohet vetëm në qoftë se përmbush të ashtuquajturat kritere të Kopenhagës për anëtarësim (Murby, 2011).

Ato janë:

- Politike: duhet të ketë institucione stabile që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut
- Ekonomike: duhet të ketë ekonomi funksionale tregu dhe të jetë i aftë të ballafaqohet me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së.
- Ligjore: duhet të pranojë ligjet dhe praktikat e BE-së, sidomos synimet madhore të bashkimit politiko-ekonomik e monetar.



Krahas këtyre kritereve, një nga gjashtë pikat e politikave të Komunitetit, të parapara me Traktatin e Mastrohtit, të vitit 1992, është Kultura. Që nga ajo kohë, BE-ja ka zhvilluar një dimension kulturor dhe politika edhe më të forta kulturore. Kultura dhe politikat kulturore janë në qendër të projekteve të BE-së. Pikërisht për këtë arsye, por edhe në një sens më të gjerë, dimension i kulturor është shumë i rëndësishëm për përditshmërinë, por edhe për proceset integruese evropiane (Bondebjerg & Madsen, 2008). Një integrim i dimensioneve të medias dhe kulturës duhet të zhvillohet në mënyrë sistematike, me një këndvështrim të dimensioneve të shumëfishta të kulturës; jo vetëm të kulturës që kuptohet si art, literaturë, film apo ide, por edhe të kulturës si përditshmëri, si vlera dhe norma, si institucione kulturore. (Bondebjerg & Madsen, 2008, p. 18)

Bashkimi Evropian ka me mijëra programe që dedikohen për vende si Kosova, për ta lehtësuar rrugën e tyre drejt integritimeve evropiane. Një pjesë e këtyre programeve kanë edhe karakter kulturor, me qëllim të stimulimit dhe përfshirjes së të rinjëve në jetën kulturore në vend, por njëkohësisht edhe në promovimin e kulturës dhe vlerave evropiane në vendë që synojnë që nesër të jenë pjesë e institucioneve evropiane.

Rol në këtë fushë luajnë edhe mediat. Ato shpesh herë, bashkë me zyrtarët përfaqësues të Bashkimit Evropian, bëhen pjesë e projekteve të përbashkëta për të promovuar këto programe, apo edhe për të transmetuar përmbajtje të punuara nga vende të tjera të Evropës.

Qëllimi i këtij punimi të masterit;

Procesi nëpërmjet të cilit shtetet i bashkohen BE-së njihet si zgjerim. Prej themelimit të saj, më 1957, BE-ja është rritur nga 6 në 28 vende anëtare. Që nga fillimi, mirëpritja e anëtarëve ishte pjesë e planit. Themeluesit e saj kishin besim në idenë e tyre që t'ua linin dyert hapur shteteve të tjera evropiane. Ndiheja vendeve që kanë potencial të bëhen anëtare, mbështetja e rritjes ekonomike dhe fuqizimi i forcave demokratike në vendet që dilnin nga diktaturat – këto ishin pjesë e përgjigjes së BE-së ndaj ndryshimeve në spektrin politik evropian në 50 vjetët e fundit. (European Union, 2014) Përderisa krahas politikave ekonomike e sociale, rol të rëndësishëm në proceset integruese evropiane luan edhe kultura, atëherë cka janë integritet kulturore evropiane? Këto politika synojnë që të adresojnë dhe promovojnë dimensionet kulturore të integritimeve evropiane përmes legjislacionit të duhur dhe fondeve qeveritare (European Commission, 2013). Këto politika mbështesin zhvillimin e aktiviteteve kulturore, edukative dhe hulumtuese, të realizuara qoftë nga



kompani private, organizata jo-qeveritare apo iniciativa individuale, të bazuara në fushat audiovizive, të filmit, të shkrimit apo muzikës (Schindler, 2012).

Komisioni Evropian zhvillon programe të ndryshme kulturore, ndërsa BE-ja ndan fonde për programe si “Muaji Kulturor Evropian”, apo “Kryeqyteti Kulturor Evropian”.

Qëllimi i këtij punim është të tregoj se cili është roli i medias në promovimin e kulturës evropiane në Kosovë, i dimensioneve të ndryshme kulturore, e njëkohësisht, përmes analizimit të legjislaturës, programeve dhe projekteve, të tregohet për angazhimin e institucioneve evropiane në këtë fushë.

Objektivat;

Institucionet vendore, por edhe ato ndërkombëtare në Kosovë, e theksojnë vazhdimisht përkushtimin e dyanshëm për zhvillimin e agjendës evropiane për Kosovën. Madje Bashkimi Evropian, përmes raporteve të ndryshme, vazhdimisht ka konfirmuar se Kosova e ndanë bashkë me shtetet e tjera të rajonit perspektivën evropiane. Kosova në prill të vitit 2008 miratoi planin për Integritim Evropian.

Por sa afër ose larg janë qytetarët e Kosovës me vlerat evropiane? Një pasqyrë e asaj se sa “evropianë” janë kosovarët paraqitet nëpër media, qoftë nëpërmjet kronikave në edicionet e lajmeve, apo edhe përmes emisioneve apo shkrimeve të ndryshme. Nga materialet mediale mund të arrihet deri te një vlerësim rreth nivelit të përgjithshëm social, edukativ, kulturor e të vetëdijes shoqërore. Por mediet, nga ana tjetër, kanë obligim që përmes programeve të tyre të ndikojnë në përmirësimin e situatës dhe në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve. Kjo gjë shpesh bëhet edhe përmes transmetimit të emisioneve, shkrimeve e produkteve të ndryshme të huaja, gjë që ndikon në ofrimin e një perspektive më ndryshe se cka ndodhë në vendet e tjera që na rrethojnë.

Kompanitë mediale, përveç fitimit të parave, duhet të kenë parasysh edhe diversitetin kulturor, shërbimin publik dhe përgjegjësitë shoqërore. Secila qeveri ka politikën e saj mediale, por kur flitet për interes të përbashkët, BE-ja cakton rregullat dhe udhëzimet (Murby, 2011).

Pyetjet që shtrihen/hipotezat

Të jesh pjesë e institucioneve evropiane është thikë me dy tehe; ekzistojnë anët pozitive, e poashtu edhe ato negative. Përderisa merr shumë kënaqësi e benificione nga ky komunitet, në të njëjtën



kohë ka shumë detyrime e obligime që duhet të përmbushen, e që janë kritetere që kërkohen nga ky trup.

Si shteti më i ri në Evropë, edhe njohja me kulturën evropiane është më e vonshme për qytetarët e Kosovës. Mungesa e lirisë së lëvizjes, mungesa e programeve televizive e të shtypit, si dhe mos-pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme kulturore me karakter evropian, bëjnë që të jemi mbrapa krahasuar me vendet e tjera.

Nga ana tjetër, përkushtimi i institucioneve evropiane për të afruar vende si Kosova në gjirin e vet, përmes programeve e projekteve të ndryshme, jep shpresë për një të ardhme më të ndritur për qytetarët e Kosovës.

Rëndësia e temës;

Për të kuptuar se në çfarë drejtimi janë duke ecur kosovarët në aspektin e integritimeve kulturore evropiane, duhet kuptuar mirë se si mund të bëhet kjo gjë, pra si mund të bëhet ky integrim. Një prej elementeve bazë në këtë hulumtim do të jetë kuptimi i funksionimit të përfaqësimit të Bashkimit Evropian në Kosovë, respektivisht i Zyrës Kulturore të BE-së në Prishtinë. Çfarë programesh ofrojnë ata, cili është qëllimi i tyre, sa ia arrijnë qëllimit dhe cili është interesimi nga ana e qytetarëve?

Aspekt tjetër me rëndësi është monitorimi i pranisë së produkteve mediale, me karakter kulturor, që kanë për qëllim promovimin e vlerave dhe të kulturës evropiane në Kosovë. Sa marrim ne nga Evropa, sa i përket muzikës, filmit, letërsisë e projekteve të ndryshme kulturore? Në anën tjetër, sa janë “mikëpritëse” institucionet evropiane për vende aspiruese si Kosova? Një hulumtim dhe monitorim i produkteve mediale që transmetohen në Kosovë, si dhe i programeve dhe aktiviteteve të ndryshme, të organizuara qoftë nga institucionet vendore apo ndërkombëtare në Kosovë, qoftë nga shoqëria civile, do të jepte një pasqyrë më të qartë të tendencave, preferencave dhe synimeve të kosovarëve sa i përket integritimeve kulturore evropiane.

Metodologjia;

Për të hartuar këtë punim, do të realizohen anketa sociologjike, intervista të thella, si dhe do të përdoret metoda e monitorimit.



Anketa sociologjike do të realizohet me dy grupmosha. Në grupmoshën e parë hyjnë adoleshentët, nga 15 – 18 vjet, ndërsa në grupmoshën e dytë personat nga 25 – 50 vjet. Qëllimi i realizimit të kësaj ankete është që të kuptohet më mirë se cilat janë synimet, këndvështrimet dhe aspiratat e respondentëve lidhur me integrimet kulturore evropiane dhe se si e shohin ata Evropën në rrafshin kulturor.

Intervistat e thella do të realizohen me njerëz kompetentë e ekspertë të fushave relevante, që japin informacione rreth programeve dhe emisioneve të ndryshme.

Për të realizuar këtë punim gjithashtu do të monitorohet arkiva, si ajo e medie, poashtu edhe e materialit e literaturës që ka të bëjë me temën.

Në fund do të mundohem të jap përfundime duke u bazuar në rezultatet e nxjerra lidhur me rolin që luan media në Kosovë në procesin e integrimi kulturore evropiane, si dhe me qëndrimet e kosovarëve lidhur me këtë process.

Rezultatet e pritura;

Synim i këtij punimi është që të arrij të tregoj sa cili është roli i medias në promovimin e kulturës evropiane në Kosovë, të dimensioneve të ndryshme kulturore, e njëkohësisht, përmes analizimit të legjislaturës, programeve dhe projekteve, të tregohet për angazhimin e institucioneve evropiane në këtë fushë.

Përmbledhje;

Është menduar që përmbajta e punimit pak a shumë të jetë e ndertuar sipas kësaj rrjedhe të mëposhtme, e cila do të shërbejë si model për ta shtjelluar temën:

Parathënie

Hyrje

- **Objekti**
- **Metodat**
- **Korpusi**

Evropa, Media dhe Integrimet Kulturore

1. Cka është Bashkimi Evropian?



2. Integrimet kulturore evropiane
3. Europeanizimi
4. Multikulturalizmi në Evropë
5. Bashkëpunimi në rrafshin kulturor

Perspektiva e BE-së në Kosovë

1. Kuizi i Evropës
2. Udhëtimi nëpër Evropë
3. Java e Evropës - Ciklizëm, Panaire, Promovime
4. Java Kulturore (Italiane, Franceze)

Emisione televizive, radiofonike dhe te shkuara

1. Dokumentarët “Le të nisemi për në Evropë”
2. Emisioni televiziv “Evropa më Afër”
3. Emisioni radiofonik në RTK Radio
4. Rubrika e shkruar “Gazeta Zëri”

Lëvizja e Lirë dhe Integrimet Kulturore

1. “Revolta e artistëve – Rasti i Jerichos”
2. YIHR – Eurotrip
3. Kosova në Biennale

Cka japim dhe marrim nga Evropa?

1. Eurosong
2. Eurodance
3. DW
4. EBU (EVN)

Përfundime

Literatura Iniciale



Literatura dhe Bibliografia

- Bondebjerg, I., 2013. *European Media, Cultural Integration and Globalisation*. [Online]
Available at: <http://www.nordicom.gu.se>
[Accessed 10 March 2014].
- Bondebjerg, I. & Madsen, P., 2008. *Media, Democracy and European Culture*. Bristol: Intellect Books.
- Deirdre, K., 2003. *Europe in the Media: A Comparison of Reporting, Representation, and Rhetoric in National Media Systems*. New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates.
- European Commission, 2013. *Education, Audiovisual and Culture Executive Agency*. [Online]
Available at: http://eacea.ec.europa.eu/culture/programme/about_culture_en.php
[Accessed 10 March 2014].
- European Commission, 2014. *Education, Audiovisual and Culture Executive Agency*. [Online]
Available at: http://eacea.ec.europa.eu/index_en.php
[Accessed 1 March 2014].
- European Union, 2014. *EU Perspective in Kosovo*. [Online]
Available at: <http://www.eupk.org>
[Accessed 5 March 2014].
- European Union, 2014. *European Union Office in Kosovo*. [Online]
Available at: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/index_en.htm
[Accessed 4 March 2014].
- Gurevitch, M., Bennett, T., Curran, J. & Woollacott, J., 2005. *Culture, Society and the media*. 6th ed. London and New York: Taylor & Francis.
- Joppke, C., 2012. *The Role of the State in Cultural Integration: Trends, Challenges, and Ways Ahead*. Washington, DC: Migration Policy Institute.
- Murby, M., 2011. *Të nisemi për në Evropë*. Mitrovica: Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.
- Samson, R., 2006. *The Cultural Integration Model and European Transformation - The case of Romania*. [Online]
Available at:
http://openarchive.cbs.dk/bitstream/handle/10398/7732/ramona_samson.pdf?sequence=1
[Accessed 2 March 2014].
- Schindler, J. M., 2012. *Culture, Politics and Europe: en route to Culture-Related Impact Assessment*. [Online]
Available at: http://www.culturalpolicies.net/ëeb/files/222/en/Culture,_Politics_and_Europe-1.pdf
[Accessed 14 March 2014].